


TENDERËT NË PANDEMI



**ANALIZA E TENDERËVE EMERGJENTË
NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE**

TABELA E PËRMBAJTJES

Shkurtime _____	3
Përmbledhje _____	4
Prokurimet në shëndetësi, më shumë se gjysma me 1 operator në garë _____	6
Tenderët për mallra dhe shërbime dedikuar pandemisë Covid-19 _____	9
Si u shpërdoruan fondet për COVID-19 në tenderë _____	13
Si devijuan Fondet e COVID-19 për shpenzime të tjera _____	14
Si u përdorën fondet e COVID-19 nga FSDKSH për shlyerjen e faturave të prapambetura _____	15

SHKURTIME

KLSH	Kontroli i Lartë i Shtetit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
KPP	Komisioni i Prokurimeve Publike
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
PBA	Projekt Buxhet Afatmesëm

PËRMBLEDHJE

COVID-19 veç të tjerash vuri në provë qeveritë dhe sistemet e tyre të prokurimeve në të gjithë botën për mënyrën se si u përdorën fondet për përballimin e një situatë jo të zakonshme. Ka dëshmi se qeveritë nëpër botë kanë abuzuar me prokurimet emergjente për të nxitur korrupsionin, dhe në këtë mënyrë kanë devijuar fondet, duke lënë shpesh pa mbështetje shtresat e varfra.¹

Teksa pandemia është në përfundim të vitit të dytë, në shumë vende sistemet e prokurimeve publike rezultuan të vjetruara, doli në pah nevoja për ndryshim të legjislacionit, nevoja për digjitalizimin dhe u vërtetua se shumë zyrtarë nuk hezitojnë për të përfutur padrejtësisht nga fondet e fatkeqësisë. Nga ana tjetër, COVID-19 u bë shkak për praktika novatore të shpejta, efikase, transparente, të cilat duhet të shërbejnë si mësim.²

Shumë shtete krijuan portale të dedikuara për përdorimin e fondeve në sektorin shëndetësor gjatë pandemisë, por në Shqipëri entet publike, dhe sidomos ato të shëndetësisë, nuk kanë bërë asnjë transparence për përdorimin e fondeve.

Në Shqipëri situata në menaxhimin e fondeve në sektorin e shëndetësisë ka mungesa të theksuara sa i takon transparencës dhe llogaridhënies. Shqipëria është ndër të pakat vende në Evropë dhe rajonin e Ballkanit që nuk ka publikuar të dhëna dhe raporte mbi efektivitetin e përdorimit të fondeve. Institutet Shkencore (ISHP) dhe të tjera si Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm nuk kanë publikuar deri më tani asnjë studim rreth sjelljes së virusit në popullsinë shqiptare. Nuk ka të dhëna mbi suverjancën e pandemisë dhe ndikimin në zona dhe grupmosha të caktuara.³

Institucioni më i lartë i auditit në vend, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), e pati mjaft të vështirë të gjurmtojë përdorimin e fondeve në sektorin e shëndetësisë gjatë pandemisë për shkak të pa rregullshmërive ligjore, që shoqëruan procesin. Si pasojë e mungesës së konsistencës së kodeve të projekteve të dedikuara për përballimin e situatës së shkaktuar nga COVID-19 dhe rishikimeve të shumta pas akteve normative me disa VKM, gjurmimi deri në realizimin përfundimtar të fondeve COVID-19 rezultoi i vështirë, thuajse i pamundur⁴.

Të gjitha shtesat e fondeve për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të akorduara me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) përgjatë vitit 2020, nuk janë reflektuar në tabelat shoqëruese respektive

¹ <https://www.open-contracting.org/2021/01/13/2020-showed-us-the-future-of-procurement-heres-how-we-will-deliver-it-in-2021/>

² https://www.open-contracting.org/ep-content/uploads/2020/10/OI-OCP-GlobalProcurementResponses_lessons.pdf

³ <http://www.ishp.gov.al/>, <https://shendetesia.gov.al/>, <https://fsdksh.gov.al/>

⁴ <http://www.parlament.al/Files/Kerkese/20211026115728Raporti%20i%20Zbatimit%20te%20Buxhetit%202020.pdf>

të Akteve Normative. Për rrjedhojë, fondet që u akorduan për përballimin e pandemisë shkuan për shpenzime të tjera që nuk kishin lidhje me pandeminë.⁵

Mungesa e transparencës në përdorimin e fondeve që shkuan për menaxhimin e pandemisë ishte aq e madhe sa u konsiderua si shqetësim nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), i cili nuk ka në thelb të punës së tij monitorimin e tenderëve. Mirëpo Fondi ka vërejtur se keq menaxhimi i fondeve publike është duke ndikuar negativisht borxhin publik të vendit, i cili është në thelb të punës së Fondit.⁶ FMN informoi se prokurimet emergjente për përballimin e pandemisë nuk ishin transparente dhe i kërkoi Kontrollit të Lartë të Shtetit të intensifikojë kontrollet dhe t'i publikojë ato.

Bazuar në metodologjinë e kontrolleve me bazë risku, Kontrolli i Lartë i Shtetit klasifikoi për audit 120 institucione këtë vit, gjysma e të cilave (rreth 50%) u vlerësuan me risk të lartë në procesin e zbatimit të ligjit, e për rrjedhojë edhe në menaxhimin e fondeve publike.

Ministria e Shëndetësisë, e cila u ndoq nga Qendra Spitalore “Nënë Tereza”, u renditen në krye të enteve publike për riskun e lartë të zbatimit të ligjit dhe të përdorimit të fondeve publike⁷.

Nga 6440 procedura të publikuara për prokurime (pa përfshirë ankande dhe koncesione) gjatë vitit 2020, për 532 ose për 8.2 % prej tyre janë paraqitur ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik. Nga numri total, Ministria e Shëndetësisë u rendit e dyta, pas Agjencisë së Blerjeve, të përqendruara për numrin e madh të ankesave, me 26 gjithsej ose rreth 5 % të totali të ankesave.⁸

Nisur nga numri total i ankesave të shqyrtuara pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se 42,7 % (317) prej tyre janë ankesa të procedurave të prokurimit të llojit “mall”. Ministria e Shëndetësisë u rendit e dyta me 20 ankesa nga operatorët që kishin marrë pjesë në tenderët e zhvilluar me blerje mallrash.⁹

Janë gjetur mospërputhje të të dhënave të kontratave të nënshkruara të publikuara nga Agjencia e Prokurimit Publik me ato të regjistruara në SIFQ (në sistemin e thesarit të Ministrisë së Financave). Ministria e Shëndetësisë u rendit e para për këtë shkelje, ku sipas APP, janë zhvilluar 601 procedura prokurimi, ndërkohë në SIFQ rezultojnë vetëm 5 kontrata¹⁰.

⁵ <http://www.parlament.al/Files/Kerkese/20211026115728Raporti%20i%20Zbatimit%20te%20Buxhetit%202020.pdf>

⁶ <https://www.imf.org/en/Publications/CR/Issues/2021/12/07/Albania-2021-Article-IV-Consultation-Press-Release-Staff-Report-and-Statement-by-the-510834>

⁷ https://www.klsh.org.al/content_pdf/96

⁸ <http://www.parlament.al/Files/Kerkese/raportimipp.pdf>

⁹ <http://www.parlament.al/Files/Kerkese/raportimipp.pdf>

¹⁰ <http://www.parlament.al/Files/Kerkese/20211026115728Raporti%20i%20Zbatimit%20te%20Buxhetit%202020.pdf>

PROKURIMET NË SHËNDETËSI, MË SHUMË SE GJYSMA ME 1 OPERATOR NË GARË

Në tenderët e sektorit të shëndetësisë gara është shumë e kufizuar. Nga tenderët e zhvilluar nga viti 2016 deri në dhjetor të vitit 2021, në 55.4% e tyre kishin vetëm një operator pjesëmarrës në garë, 35% kishin më shumë se dy operatorë në garë.

Nga viti 2016 në vitin 2021 për vetëm 47% të tenderëve të zhvilluar pati kontrata të lidhura. 8.4% fituesve përfituan shtesa kontrate, ndërkohë 15.8% të procedurave të tenderëve u anuluan. Ndërsa më shumë se 2% e tenderëve të rishpallur janë anuluar sërish. Për 16% të tenderëve të zhvilluara ndërmjet 2016-2021 është shpallur fituesi por nuk është lidhur kontrata¹¹.

Duke i klasifikuar sipas procedurës, shihet se gara e hapur u përdor vetëm në 31% të shpalljeve, teksa 17% e tenderëve u bënë sipas procedurës me negociimin. Kjo procedurë mbizotëroi gjatë pandemisë, ndërsa 32% e shpalljeve u bënë sipas procedurës kërkesë për propozim.

Ndërsa për pjesën e tenderëve në sektorin e shëndetësisë që janë bërë me garë të hapur, ka një seri ankesash për autoritetet kontraktuese, të cilat përpilojnë kritere teknike përjashtuese duke favorizuar në mënyrë indirekte kompanitë e lidhur me autoritetin kontraktor.

Shembull 1:

Në datën 20.07.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF65892-07-18-2020, me objekt “F.V Pajisje mjekësore –CT Scanner”, me fond limit 144.112.500 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 17.08.2020, nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë . Fitues u shpall kompania Montal.

Por dy kompanitë e tjera në garë Health &Light” sh.p.k. dhe “BNT Electronics”, u ankuan në Komisionin e prokurimit publik në korrik të vitit 2020, për modifikimin e kritereve teknike nga Ministria e Shëndetësisë që favorizonin kompaninë fituese Montal.

“Na lejoni të shprehim sa më poshtë vijon objeksionet tona në lidhje me këtë procedurë prokurimi në përgjithësi dhe me mënyrën se si janë hartuar specifikimet teknike në veçanti. E gjejmë këtë procedurë prokurimi të përgatitur tërësisht për një prodhim nga një kompani e cila përfaqësohet në territorin e

¹¹ <https://openprocurement.al/sq/health/index>

Republikës së Shqipërisë nga shoqëria “Montal” sh.p.k.. Me saktësisht, specififikimet e kërkuara teknike për CT Scanner 64 slice, flasin qartë për prodhimin REVOLUTION EVO GEN 2. ndërsa për CT Scanner 16 slice, flasin qartë për prodhimin OPTIMA 540 16 slice Këto specififikime janë hartuar në mënyrë të tillë që i plotësojnë vetëm këto prodhime dhe askush tjetër. Nga njëra anë ato janë hartuar si një fotokopje e keqe e prodhimeve të sipërpërmendura dhe nga ana tjetër vëmë re një tendence mjaft të hapur që kjo procedurë prokurimi të fitohet nga shoqëria “MONTAL” sh.p.k.. Historikisht në procedura të mëparshme të hartuara dhe përgatitura nga ky ent prokurues nuk ka pasur asnjëherë *specifikime të cilat ishin* përjashtuese për prodhues të tjerë me emër si p.sh Siemens, Philips, Canon (Toshiba) etj. Duhet thënë që këta prodhues kanë në portofolin e tyre të prodhimeve mjaft specififikime superiore ndaj këtyre specififikimeve, por që nuk janë vendosur nga Ministria e Shëndetësisë” argumentuan kompanitë e shkualifikuara nga gara¹².

Komisioni i Prokurimit vendosi të pranojë pjesërisht ankesat, pasi ligji aktual nuk ka kufij të përcaktuar për kriteret teknike dhe e kërkoi Ministrisë së Shëndetësisë të marrë në konsideratë ankesat dhe të rregullojë procedurat e garës sipas ankesave të operatorëve”

Më shtator të vitit 2020 gara u përsërit, dhe në të morën pjesë 8 kompani dhe sërish u shpall fituese kompania Montal me vlerë 99,7 milionë lekë me një vlerë 22 për qind më të lartë se oferta e kompanisë tjetër garuese “Medfau” prej 79.7 milionë lekësh.

Kompanitë pjesëmarrëse në garë “Medfau” dhe BTN elektroniks u ankuan sërish në Komisionin e Prokurimit publik. Ata pretenduan se, “kompanitë pjesëmarrëse në këtë procedure të hapur prokurimi e kishin shprehur që në momentin e publikimit të specififikimeve teknike (që do të kishte në mënyrë absolute favorizim të kompanisë prodhuese GE - Montal si përfaqësi e tyre në Shqipëri). Këtë shqetësim ne e kemi shprehur edhe në ankesën që kompania Medfau SHPK ka bërë pranë autoritetit kontraktor. Edhe në ankimin që kompania BNT Electronics dhe Health & Light ka bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duket qartë që specififikimet teknike të publikuara janë për të favorizuar një kompani prodhuese GE, madje në ankesën drejtuar këtij komisioni janë shprehur edhe modelet, të cilat janë paracaktuar të fitojnë, konkretisht modelet e CT të kompanisë prodhuese GE - REVOLUTION EVO DHE OPTIMA 540.¹³”

Komisioni i Prokurimit Publik vendosi për së dyti a anulimin e garës, duke i kërkuar Ministrisë së Shëndetësisë të ofrojë garë të hapur dhe me kriteret logjike.

¹² https://openprocurement.al/health/vendime_kpp/162185419625556kpp.pdf

¹³ <https://kpp.al/al/Historiku>

Ky është vetëm një rast se si autoritet kontraktuese në sektorin e shëndetësisë këmbëngulin që për disa herë rresht të shpallin fituese të njëjtën kompani, edhe pse vlera monetare e ofruar është më e lartë dhe kriteret teknike u cilësuan absurde.

Kjo procedurë vonoi për gati dy vite instalimin e skanerit, duke ndikuar kështu në mënyrë direkte në shërbim të cunguar ndaj pacientëve. Skaneri gjatë pandemisë COVID ishte nga shërbimet më të kërkuara nga të sëmurët, pasi shkalla e saktë e dëmtimit të mushkërisë evidentohet me skaner. Shumë pacientë iu drejtuan klinikave private për shërbimin e skanerit dhe duke u përballur në këtë mënyrë me tarifa dhe kosto të larta për përballimin e pandemisë.

TENDERËT PËR MALLRA DHE SHËRBIME DEDIKUAR PANDEMISË COVID-19

Që nga fillimi i pandemisë e deri në fillim të dhjetorit 2021, autoritet shëndetësore publike në të gjithë vendin zhvilluan 198 procedura prokurimi që kishin lidhje me përballimin e krizës shëndetësore COVID-19. Vlera e fondit limit në dispozicion ishte 5.3 miliardë lekë, ndërsa vlera totale e shpallur fituese ishte 4,4 miliardë lekë pa TVSH. 90 tenderë u bënë vetëm me një operator konkurrues, të cilët përfituan një vlerë 2,3 miliardë lekësh nga 2.5 miliardë që ishte fondi limit.¹⁴

Nga marsi 2020 deri në maj 2021, institucionet e shëndetësisë kontraktuan 60 kompani për furnizime materiale që kishin lidhje me COVID-19. 11 nga kompanitë ose 18% e totalit të kontratave ishin sekrete. Gjithashtu 11 kontrata të treta ose 18% e operatorëve fitues kishin vetëm vlerën e çmimit për njësi dhe jo shumen totale¹⁵.

Në Renditje, sipas Vlerës së Kontratës së Fituar në Shëndetësi, për kontraktim blerje, investim apo porosi për COVID-19, Mars 2020 – Maj 2021, biznesi i parë më i kontraktuar në vlerë është shoqëria GTS-Gazra Teknike Shqiptare shpk, e cili siguroi mbi 2,4 miliardë lekë fonde publik, ose 47% të fondeve totale të gjetura në listën e Agjencisë së Prokurimeve Publike. GTS-Gazra Teknike Shqiptare ishte burimi kryesor i furnizimit të spitaleve COVID-19 me oksigjen.

Kontraktuesi i dytë më i madh ishte kompania Evita me 627 milionë lekë dhe e treta Intermed me 384 milionë lekë. Të 59 kompanitë u kontraktuan nga institucionet e shëndetësisë për furnizimin e furniturës mjekësore për COVID (pajisje për spitale, oksigjen dhe barna konform protokolleve anti-COVID, etj)⁴⁰.

Nga 59 kompanitë që u kontraktuan, rezulton se vetëm 39 prej tyre ose 66% morën pagesat gjatë periudhës mars 2020-maj 2021. Të dhënat vlejné për kompanitë që i kanë kontratat me vlera të publikuara.

Nga 2.4 miliardë lekë pagesa që u bënë nga thesari gjatë mars 2020-maj 2021, mbi 1 miliard lekë, ose 41 % e totalit iu dhanë kompanisë GTS, që siguroi furnizimin me oksigjen të spitaleve. Kompania Evita ishte e dytë për sasinë më të madhe të disbursimeve me 281 milionë lekë dhe Euromed e treta me 137 milionë lekë.¹⁶

¹⁴ https://openprocurement.al/sq/htender/covid/bidder_no/1?

¹⁵ <https://openprocurement.al/en/htender/covid>

¹⁶ <https://openprocurement.al/en/htender/covid/faqe/3>

Operator Ekonomik Kontraktues	Tenderime Vlera e fituar Pa TVSH
GTS-Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k.	2,084,154,082
EVITA SHPK	627,510,300
INTERMED SHPK	384,590,308
Biometric Albania SHPK	203,645,500
MESSER ALBAGAZ SHPK	196,495,440
EUROMED SHPK & Farma Net Albania SHPK	189,585,000
OES Distrimed SHPK	185,067,400
EUROMED SHPK	133,247,145
EUROVIA shpknj	101,430,000
Farma Net Albania	92,384,000
Gen-Alb Farma SHPK	84,935,000
FEDOS SHPK	57,340,180
XPERT SYSTEMS	40,155,500
ECO RICIKLIM	9,811,200
KRIJON SHPK	7,086,000
Aquarius Medical	5,884,542
Intelligent Building Solution (I.B.S.) - R & T	5,000,000
ALPEN PULITO	4,242,854
4 S	4,150,750
MEDI-TEL SHPK	2,730,112
LOERMA	2,647,259
GREEMED SHPK	2,072,000
JUPITER GROUP	1,525,000
SULLOLLARI-KLIMA	1,195,750
Nertil Shehaj	600,000
Jimi	545,900
ARTEO 2018	319,000
MOTO-MANIA	275,000
CFO PHARMA	239,000

Erlind Asllani	180,000
FLORFARMA SHPK	146,300
EURO MEGA 2010	99,900
MAJ-ALB	14,000
Human Vaccine LLC	vaksina
KEYMEN ILAC SANAYI VE TICARET ANONIM SIRKETI	vaksina
GAVI Alliance	vaksine
Pfizer export bv	vaksina
Biometric Albania SHPK	sekrete
EURO MEGA 2010	sekrete
Farma Net Albania SHPK & EUROMED SHPK	sekrete
FEDOS SHPK	sekrete
Genius SHPK	sekrete
KRIJON SHPK	sekrete
MEDICAMENTA SHPK	sekrete
MEGAPHARMA SHPK	sekrete
OES Distrimed SHPK	sekrete
Rejsi FARMA SHPK	sekrete
T B S 96 SHPK	sekrete
TEOREN	sekrete
Aldosch-Farma SHPK	ofruar vlere çmim për njësi
EDNA - FARMA SHPK	ofruar vlere çmim për njësi
INCOMED SHPK	ofruar vlere çmim për njësi
LEKLI SHPK & MEGAPHARMA SHPK	ofruar vlere çmim për njësi
MEDICAMENTA SHPK	ofruar vlere çmim për njësi
Megapharm - DELTA PHARMA - AL - Incomed	ofruar vlere çmim për njësi
MEGAPHARMA SHPK	ofruar vlere çmim për njësi
MEGAPHARMA SHPK & ALBANIA NEË PHARM SHPK	ofruar vlere çmim për njësi

Pegasus SHPK	ofruar vlera çmim për njësi
Rejsi FARMA SHPK	ofruar vlera çmim për njësi
TRIMED SHPK	ofruar vlera çmim për njësi
TOTALI	4,429,304,422
<i>Burimi :http://openprocurement.al/sq/htender/covid</i>	

SI U SHPËRDORUAN FONDET PËR COVID-19 NË TENDERË

Më 17 mars të vitit 2020, Ministria e Shëndetësisë shpalli procedurën e prokurimit të drejtpërdrejtë për blerjen e respiratorëve (54 të tillë) me një fond limit 129 milionë lekë (1,1 milionë euro)¹⁷. Kriteri kryesor, sipas ftesës për ofertë nga Ministria e Shëndetësisë, ishte çmimi i ulët i pajisjeve. Çmimi për njësi ishte më shumë se 20 mijë euro, ndërkohë që çmimet e ventilatorëve në tregjet ndërkombëtare variojnë nga 6000 në 50,000 euro¹⁸.

Kontrata e klasifikuar sekret u fitua nga kompania TBS 96, e cila ka sjellë vetëm 5 respiratorë nga 54 gjatë vitit 2020, ndërsa detyrimi në kontratë ishte 20 respiratorë brenda 7 ditëve, ndërkohë kontrata me kompaninë është ende në fuqi.

Për furnizime me mallra anti-COVID, Ministria e Shëndetësisë ka vijuar me procedura prokurimi të drejtpërdrejta dhe nuk i është referuar kuadrit ligjor në fuqi, edhe pse plotësohen të gjitha kushtet një nevojë ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, e që nuk i ngarkohen autoritetit kontraktor.

Si pasojë e procedurave të përzgjedhura dhe vakumeve ligjore të VKM nr. 203 datë 26.02.2020, disa procedura rezultuan jo efektive, duke mos siguruar pajisjet mjekësore të domosdoshme për situatën COVID-19 (siç ishte rasti i respiratorëve), apo duke sjellë dështimin e disa procedurave të tjera, ku gjatë vitit 2020 duhet të silleshin sipas kontratës 54 respiratorë, por u sollën vetëm 5. Përveçse kjo kontratë dështoi, autoriteti kontraktor (në këtë rast Ministria e Shëndetësisë) krijoi një dëm prej 15 milionë lekësh nga moslogaritja e penaliteteve dhe mos mbajtja e sigurimit të kontratës si pasojë e furnizimit të vonuar dhe mos furnizimit për kontratën me objekt “Furnizim vendosje respiratore me dy modalitete për adulte dhe moshe pediatrike për COVID-19”. Në përfundim u siguruan vetëm 5 respiratorë, nga 54 që ishte planifikuar nevoja për përballimin e situatës COVID, duke rrezikuar kështu shëndetin publik¹⁹.

¹⁷ <https://shendetesia.gov.al/pese-respiratore-te-rinj-te-shefqet-ndroqi-manastirliu-lidhet-me-stafin-e-covid-2-rrisim-kapacitetet/>

¹⁸ <https://hcpresources.medtronic.com/blog/high-acuity-ventilator-cost-guide>

¹⁹ <http://www.parlament.al/Files/Kerkese/20211026115728Raporti%20i%20Zbatimit%20te%20Buxhetit%202020.pdf>

SI DEVIJUAN FONDET E COVID-19 PËR SHPENZIME TË TJERA

KLSH ka konstatuar raste të ndryshimit të destinacionit të fondeve COVID në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në shumën 16.7 milion lekë, të cilat u përdorën për shlyerjen e detyrimeve të kontratave ose projekteve të mëparshme, ku më konkretisht vlera prej 15.8 milionë lekë për shlyerje detyrimesh për blerje pajisjesh kompjuterike, dhe vlera prej 0.96 milionë lekë përdorur për blerje pajisjesh kompjuterike planifikuar në PBA 2020 – 2022, pra përpara fillimit të pandemisë²⁰.

²⁰ <http://www.parlament.al/Files/Kerkese/20211026115728Raporti%20i%20Zbatimit%20te%20Buxhetit%202020.pdf>

SI U PËRDORËN FONDET E COVID-19 NGA FSDKSH PËR SHLYERJEN E FATURAVE TË PRAPAMBETURA

Nga auditimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit, konstatohet se një pjesë e fondit rezervë anti-COVID të alokuar për Fondin e Sigurimit Shëndetësor të Detyrueshëm është përdorur për shlyerjen e detyrimeve për energji, ujë dhe vendime gjyqësore për spitalet publike. Me VKA nr. 9 datë 28.07.2020, është miratuar shpërndarja e fondeve në shumën 521,580 mijë lekë (210 milionë lekë për shpërblimet e personelit të COVID dhe pjesa tjetër për nevoja në artikullin 602). Pakësimi i rezervës së caktuar për COVID-19 është detajuar për t'u përdorur për shpërblimin e personave të përfshirë në vijën e parë të luftimit të pandemisë, si dhe për kërkesat e tjera të spitaleve në artikullin 602 (për transport pacientësh me dializë, energji, ujë, vendime gjyqësore, si dhe shtesë fondi për Spitalin Gjirokastër për realizimin në vazhdimësi të shërbimit të dializës).²¹

²¹ <http://www.parlament.al/Files/Kerkese/20211026115728Raporti%20i%20Zbatimit%20te%20Buxhetit%202020.pdf>